

## **INFORMACION MBI EKVIVALENTIMIN E LICENCËS PËR SHOQËRITË E HUAJA DHE INDIVIDË TË CILËT SHPREHIN INTERES PËR MARRJEN PJESE NË PROCEDURËN E PROKURIMIT**

### **RISHIKIM I STUDIMIT TË FIZIBILITETIT DHE HARTIMI I PROJEKTIT TË DETAJUAR INXHINIERIK "NDËRTIMIN E TUNELIT TË LLOGARASË"**

Bazuar në Vendimin. Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", subjektet fizike / juridikë aplikojnë në portalin e-albania për tu pajisur me licencë në fushat përkatëse.

Portali e-albania ofron shërbimin për individë dhe shoqëri, vendas dhe të huaj në të cilin ngarkohet dokumentacioni on line sipas kërkesave përkatëse.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton se vetëm për aplikantët (shoqëri të huaja/ individ të huaj) të interesuar për marrjen pjesë në procedurën e prokurimit me objekt "Rishikim i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik "Ndërtimin e Tunelit të Llogarasë" do të aplikohet procedurë e përshpejtuar për 5 ditë.

Subjektet e interesuar duhet të përmbushin dokumentacionin si më poshtë:

Për ekuivalentimin e licencës për shoqëri të hua;

1. Licencë e shoqërisë nga vendi i origjinës, (licencë / rregjistrim në urdhërat përkatës / dokumentacion të barazvlefshëm me këto 2 të parat) të apostiluar nga vedni i origjinës dhe përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe;
2. Diplomë e nivelit master të lëshuar nga vendi i origjinës për drejtuesit teknik (të apostiluar nga vedni i origjinës dhe përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe);
3. Kontrata e punës ndërmjet drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të përkthyer dhe e noterizuar, me afat punëmarrje jo më pak se 1 vit në pozicionin e drejtuesit teknik për fushën përkatëse; (projektim / mbikëqyrje dhe kolaudim);
4. Vetdeklarimi 6/1 , 6/2, dhe 6/5;
5. Vetdeklarimi 6/3 për drejtuesin ligjor;
6. Jetëshkrimi i shoqërisë lidhur me eksperiencën në vendin e origjinës;
7. Dokumentacion justifikues në lidhje me eksperiencën (vërtetime / referenca / projekte të nënshkruara);
8. Mandati i arketimit (150 lek per cdo kerkese bashkelidhur);

Për ekuivalentimin e licencës për individ të huaj;

1. Licencë individuale nga vendi i origjinës (licencë / rregjistrim në urdhërat përkatës / dokumentacion të barazvlefshëm me këto 2 të parat) të apostiluar me vulë apostile nga vedni i origjinës dhe të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe;
2. Diplomë e nivelit master të lëshuar nga vendi i origjinës. (të apostiluar nga vedni i origjinës dhe përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe);

3. Vetdeklarimi 6/1 , 6/2, 6/3 dhe 6/4 (plotesohen sipas kërkesave përkatëse për licencim për herë të parë / shtesë kategorie / rinovim);
4. Jetëshkrim i detajuar në lidhje me eksperiencën e individit në lidhje me fushën për të cilën aplikon;
5. Dokumentacion justifikues në lidhje me eksperiencën (vërtetime / referenca / projekte të nënshkruara);
6. Mandati i arketimit (150 lek per cdo kerkese);

Për individët linku i aplikimit është

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=11144](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11144);

Për shoqëritë linku i aplikimit është

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=11142](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11142)

Për cdo paqartësi shoqëritë mund të kontaktojnë drejtpërdrejtë me z. Enian Sina Drejtor i Drejtorisë së Derregullimit Lejeve Licencave dhe Monitorimit në numrin e telefonit 068 2055586, ose ne adresën e mail: [enian.sina@infrastruktura.gov.al](mailto:enian.sina@infrastruktura.gov.al) dhe [licencat@infrastruktura.gov.al](mailto:licencat@infrastruktura.gov.al).